

VENDIM
Nr.889, datë 21.12.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIM-ASFALTIMI I
SHESHIT TË PALLATIT TË SPORTIT, NË BASHKINË E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemim - asfaltimi i sheshit të Pallatit të Sportit, në bashkinë e Shkodrës.
2. Pronarët e pasurive pronë private, që shpronësohen për sipërfaqen prej 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) m² truall, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, është 10 008 000 (dhjetë milionë e tetë mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e saj.
4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të këtij projekti.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Shkodrës.
6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Shkodrës, për realizimin e këtij projekti.
7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) m² truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Shkodrës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Ngarkohen bashkia e Shkodrës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha